

QËNDRUESHMËRIA DHE ETIKA NË CANON

MBROJTJA DHE PRIVATËSIA E TË DHËNAVE

Canon

Vizioni i kompanisë tonë është të veprojmë sipas filozofisë sonë Kyosei, që do të thotë të jetojmë dhe punojmë së bashku për të mirën e përbashkët. Ne jemi një zgjedhje biznesi të përgjegjshëm, me masa në zbatim për përgjegjësinë tonë shoqërore ndaj impakteve mbi mjedisin, të drejtat e punës dhe të njeriut, etikës dhe ofertave të qëndrueshme.

Kjo aspiratë reflektohet edhe në qasjen e Canon ndaj privatësisë. Vizioni ynë për privatësinë, "Mbrotjtja e të dhënave tuaja personale", pasqyron qasjen tonë etike dhe të përqendruar te njeriu, si dhe mbështet më tej Kodin e Sjelljes së Canon.

Kodi i Sjelljes i grupit Canon përcakton qëndrimin e drejtuesve të grupit Canon dhe përcakton standarde specifike sjelljeje që të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e grupit duhet të respektojnë në kryerjen e detyrave të tyre. Canon pajtohet me disa rregulla universale të sjelljes që na mundësojnë "të ecim përpara në frymën e 'tri vetëve' - vetëmotivimit, vetëmenaxhimit dhe vetëdijes". Canon ka besuar dhe praktikuar prej kohësh parimin e rëndësishëm se njeriu duhet të mbajë gjithmonë një qëndrim pozitiv ndaj punës së vet duke:

- 1** Kuptuar pozicionin, rolin dhe statusin në të cilin është caktuar (vetëdija)
- 2** Marrë nisma për t'u angazhuar në mënyrë aktive në detyrat me të cilat përballlet njeriu (vetëmotivimi)
- 3** Menaxhuar si duhet vetveten (vetëmenaxhimi).

Dispozitat e ndryshme të Kodit të Sjelljes së grupit Canon e gjejnë frymëzimin e tyre tek "tri vetët".

Canon është njohur gjithashtu si një nga kompanitë më etike në botë për vitin 2022, për të pestin vit radhazi, nga Ethisphere Institute, një lider global në përcaktimin dhe avancimin e standardeve të praktikave etike të biznesit, dhe ne vazhdimisht përpiqemi të rrënjosisim vlerat etike të Canon te furnitorët tanë.

Kodi i Sjelljes i Furnitorit i Canon thotë se Canon pret që furnitorët të ndërmarrin vetëm reklama të ndershme, etike dhe të përgjegjshme. Më tej theksohet se furnitorët duhet të promovojnë biznes të drejtë, të ndershëm dhe transparent dhe të kenë politika të mira korporative dhe praktika rregullative.

Kodi i Sjelljes i Furnitorit mund të lexohet te http://www.canon-europe.com/about_us/coc/cenv/en.

